



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



ATV
Arber Geci
Drejtore
Prishtinë

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

01 -12- 2023

Ref. 2312/1182/KPM/jm

VENDIM

Lidhur me Rasti: 2023/10: Ankesa e z. Fatlum Jashari (Palë ankuese)
kundër ATV (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele, e cila ka hyrë në fuqi më 28 maj 2013. Me këtë Rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM me datën 2 shkurt 2023 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese ndaj serialit vendor "3 Vllaznit", i cili transmetohet në ATV. Pala ankuese pretendon se ky serial promovon dhunë seksuale ndaj femrave, duke theksuar se: "Përveç që po paraqitet lloj-lloj degradimi pa fije turpi, aty po promovohet dhuna seksuale, ku pronari i shtëpisë Bajrami e godet në pjesët intime pa lejen e saj shërbëtoren e shtëpisë... Këtë serial po e shikojnë edhe fëmijët (Shih emisionin "E diela vlen", të Brenda Nebihut 22 janar 2023, kur vajza e mitur thotë se e shikoj serialin "3 Vllaznitë". Ky është një skenar i përkthyer, por duhet ta kuptojmë se këto skena i bëjnë dëm shoqërisë e sidomos kësaj tonës..."
3. KPM me datën 7 shkurt 2023, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga ana e Palës përgjegjëse.
4. KPM, duke u bazuar në Raportin e monitorimit të datës 22 shkurt 2023 ka gjetur se Pala përgjegjëse me datën 29 janar 2023 rreth orës 21:00 në kuadër të serialit "3 Vllaznit" ka transmetuar përmbajtje programore e cila i takon kategorisë së tretë dhe duhet të transmetohen nga ora 22:00, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele.
5. KPM, me datën 8 mars 2023 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilën e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-

2013/01. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

6. KPM datën 14 mars 2023 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse në të cilën thuhet se: *“Në anën tjetër sa i përket shkeljes së rregullores KPM-2013/01, nenit 6 paragrafit 3, na duhet të pranojmë që kjo ka qenë një gabim teknik që i është përvjedhur produksionit. Kjo për faktin që skenari shkruhet nga dramaturgu nga Bosnja Hercegovina, ku sipas Agjencisë rregullatore të komunikimeve në BeH, programet që ndalohen të transmetohen para orës 22:00 i përkasin kategorisë 16+. Prandaj, duke shprehur keqardhjen tonë për gabimin evident, ne konsiderojmë që seriali “3vllaznit” sipas rregullores për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet audio-vizuale të KPM-së (KPM-2013/01), është program i cili nuk ka përmbajtje të dëmshme, dhe mund të transmetohet para orës 22:00.”*
7. Për të vërtetuar se Pala përgjegjëse pas Njoftimit për shkelje është duke e transmetuar serialin “3 Vllaznit” në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, KPM ka bërë sërish monitorim. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 22 mars 2023 është gjetur se Pala përgjegjëse vazhdon ta transmetojë serialin “3 Vllaznit” me shenjën 14+ në orën 21:00, gjë e cila është në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01, përkatësisht me nenin 6, paragrafin 3, sipas të cilit përmbajtjet programore të kategorisë së tretë mund të transmetohen prej orës 22:00 deri në orën 06:00. Gjithashtu, Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të këtij seriali ka përdorur simbol përkatës të ndryshëm nga ajo e përcaktuar në Aneksin e Rregullores, veprim ky në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/01.

Analiza ligjore

8. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 3 dhe nenin 7, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/01.
9. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse vazhdon ta transmetojë serialin “3 Vllaznit” me shenjën 14+ në orën 21:00, gjë e cila është në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Audio-vizuale, përkatësisht nenin 6, paragrafi 3, sipas të cilit përmbajtjet programore të kategorisë së tretë mund të transmetohen prej orës 22:00 deri në orën 06:00.

Neni 6, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01 përcakton se:

“Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në orën 06:00.”

10. KPM, gjithashtu ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të këtij seriali ka përdorur simbol përkatës të ndryshëm nga ajo e përcaktuar në Aneksin e Rregullores, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/01, i cili përcakton se:

“Subjektet transmetuese do të përdorin piktogramet të paraqitura në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.”


11. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 3 dhe nenit 7, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/01.

Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 3 dhe nenit 7, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele.
13. Obligohet Pala përgjegjëse që ta transmetojë serialin “3 Vllaznit” me shenjë 14+ në orën 22:00, ashtu siç përcaktohet me nenin 6, paragrafin 3, sipas të cilit përmbajtjet programore të kategorisë së tretë mund të transmetohen prej orës 22:00 deri në orën 06:00.

E drejta për ankesë

14. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar



24.11.2023
Datë